



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 05 korrik 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1745_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 9 të Kodit të Rrjetit – Kodit të Planifikimit; dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) nr. 2593 të datës 27.12.2022 për shqyrtim dhe pëlqim të dokumentit: Planit i Adekuacisë së Gjenerimit 2023 -2032,

në seancën e mbajtur me datë 05 korrik 2023, nxori këtë:

V E N D I M

I. JEPET PËLQIMI - për publikimin e Planit të Adekuacisë së Gjenerimit 2023-2032.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 27.12.2022 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (në tekstin e mëtejme: KOSTT SH.A.), Planin e Adekuacisë së Gjenerimit 2023-2032 për dhënien e pëlqimit për publikim.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, respektivisht në bazë të obligimeve që rrjedhin nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit - Kodi i Planifikimit Neni 9, Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo dy (2) vite përgatit dokumentin Planit i Adekuacisë së Gjenerimit, i cili po ashtu duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat teknike të përshkruara në Doracakun e Operimit të ENTSO-E.

ZRRE ka analizuar versionin e draft/ Planit të Adekuacisë së Gjenerimit 2023-2032 dhe ka konstatuar se i njëjti nuk është i harmonizuar me dokumentet strategjike sipas kërkesave ligjore, dhe ka kërkuar nga KOSTT që dokumentin Planit i Adekuacisë së Gjenerimit 2023- ta përshtatë sipas Strategjisë së Energjisë.

Pas aprovimit të Strategjisë së Energjisë 2022-2031 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, KOSTT ka harmonizuar dokumentin Planit i Adekuacisë së Gjenerimit 2023-2032 me Bilancin Afatgjatë të Energjisë Elektrike 2023-2032 dhe me Strategjinë e Energjisë dhe të njëjtin e ka dërguar në ZRRE për aprovim.



Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur për dhënien e pëlqimit për publikim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Garib Bucaj, Anëtar

Pëlqimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji